

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E DIASPORËS / MINISTRY OF DIASPORA / MINISTARSTVO ZA DIASPORU

Nr. i Prot. 1507-1
 Broj Prot. 1507-1
 Prot. No. 1507-1

Nr. i Faqeve 03
 Br. Stranica 03
 No. Pages 03

Prishtinë / a

07-1
 07-12-2017



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – Ministarstvo za Dijasporu i Strateška Ulaganja – Ministry of Diaspora and Strategic Investments

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4, të Ligjit nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike bën:

**Shpallje të konkursit
për marrëveshje për shërbime të veçanta**

<i>Emri i Institucionit:</i>	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike
<i>Njësia Organizative:</i>	Departamenti i Financave dhe i Shërbimeve të Përgjithshme
<i>Titulli i punës:</i>	Ofrues i shërbimit të recepcionit
<i>Numri i referencës:</i>	MeD/01/2017 /M.SH.V/4
<i>Tarifa e shërbimit:</i>	407.26 bruto €
<i>Raporton te:</i>	Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informativë dhe Shërbimeve të Logjistikës
<i>Lloji i kontratës:</i>	Marrëveshje për shërbime të veçanta – (MSHV)
<i>Kohëzgjatja e kontratës:</i>	5 muaj 29 ditë
<i>Orari i punës:</i>	I plotë
<i>Numri i ekzekutuesve:</i>	1 (një)
<i>Vendi:</i>	Prishtinë
<i>Data e fillimit:</i>	19.12. 2017

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. U përgjigjet kërkesave të palëve lidhur me Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, i orienton ato dhe jep informacione të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi;
2. Njofton zyrtarët përmes telefonit për vizitorët;
3. I pret vizitorët në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, njoftohet për qëllimin e vizitës së tyre dhe i njofton zyrtarët përkatës të Ministrisë lidhur me vizitorin;
4. Monitoron hyrje-daljen e vizitorëve dhe i pajis me leje kalimi, nëse kërkohet për qasje në institucion si dhe i evidenton vizitorin në librin e vizitorëve;
5. Adreson postën zyrtare fizike dhe e përcjell atë te arkiva;
6. Kryen edhe detyra të tjera shtesë të cilat kërkohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë;

Shkathësitë e kërkua (*Kualifikimet, përvojat dhe aftësitë e shkathësitë e tjera që kërkohen për këtë vend të punës*):

- Shkolla e mesme;
- Të jetë i aftë ta përballojë dhe ta organizojë punën;
- Njohja e mirë e MS-Office dhe e internetit;
- Njohja e gjuhës angleze e dëshiruar;
- Aftësi në punë nën presion dhe fleksibilitet.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë konkurs:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12, paragrafi 4, të Ligjit nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike / Divizioni i Burimeve Njerëzore, zyra nr. 008, kati përdhes, ndërtesa e ish-Gjykatës Themelore të Prishtinës, 10000, Prishtinë, ose mund të shkarkohen në ueb-faqen <http://medrks-gov.net/>

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore.

Tel. 038 200 17 024, prej orës 8:00 – 16:00.

- *Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike, nga dita e publikimit **07. 12. 2017** deri më: **14. 12. 2017**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.*
- *Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 2 ditësh; aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.*
- *Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës, për të cilin konkurrohet.*
- *Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen!*
- *Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.*
- *Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit. Ata janë të obliguar t'i sjellin me vete dokumentet origjinale për kualifikimet dhe trajnimet e kryera, për verifikim para komisionit intervistues.*

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.